

URDHËR
Nr. 1018, datë 25.11.2024

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikës 3, të nenit 15, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; dhe të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të Sekretarit të Përgjithshëm z. Albin Gega, drejtor i përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Punësimit, Aftësimit dhe Sigurimeve në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

2. Kompetencat e deleguara të Sekretarit të Përgjithshëm do të ushtrohen nga data 26.11.2024 deri më 3.12.2024.

3. Ngarkohet z. Albin Gega për zbatimin e këtij urdhri, Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri, si dhe të gjithë punonjësit për zbatim.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Blendi Gonxhja